



Pranimë / Dorezuar Emiljena / Podato Received / Delivery	14. 11. 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BASHKICK	7071/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.833/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca- anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.833/2022 të datës 29.09.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike-administrative "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 11.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numër A.nr.833/2022 të datës 29.09.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar Agjencinë e Kosovës për Forenzikë me Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar të datës 22.07.2013 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësi", me datë 29.09.2022 përmesë E-mailit në ankesa.kpmsk@rks-go.net ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5747/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Akt Emërimit me numër AE. Nr. 141/2022 të datës 30.08.2022 të Zëvendësueses së Zyrtarit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, ndërsa kjo e fundit më datë 13.10.2022 ka përcjell në Këshill përgjigjen me numër protokollit 6149/2022 së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.09.2022 me Nr.protokolli 5747/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga SH.D. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 29.09.2022; Akt Emërim i SH.D. me numër AE.Nr. 141/2022 i datës 30.08.2022; E-mail nga L.B. për B.O. etj. i datës 30.06.2021; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e SH.D. e datës 22.07.2013; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.10.2022; Përgjigje në ankesë e datës 13.10.2022; Rregullore (MPB) Nr. 06/2015 për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të personelit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë; Vendim për Deklarimin e statusit të Nëpunësit, si nëpunës i Shërbimit Publik për SH.D. me Nr. Protokolli AKF/2022-157 i datës 06.10.2022; Informim me numër protokoli 5975/2022 i datës 07.10.2022; Vendim i KPMSCHK me numër protokoli 4614/2022 i datës 09.08.2022; Vendim për Anulim të Akt Emërimit me nr. AE.Nr. 141/2022 i datës 30.08.2022 të lëshuar për SH.D. me Nr. Protokolli AKF/2022-158 i datës 06.10.2022; E-mail nga H.K. për C.Z. i datës 24.10.2022; E-mail nga C.Z. për H.K. i datës 24.10.2022; Lista lidhur me deklarin e statusit të zyrtarëve publik e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit [redacted] është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar Agjencinë e Kosovës për Forenzikë me Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar të datës 22.07.2013 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësi". Zëvendësuesja e Zyrtarit Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë ka nxjerrë Akt Emërimit me numër AE. Nr. 141/2022 të datës 30.08.2022 për [redacted] për vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit" në Divizionin për Cilësi.

Ankuesi me datë 29.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5747/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Akt Emërimit me numër AE. Nr. 141/2022 të datës 30.08.2022 të Zëvendësueses së Zyrtarit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë me pretendime ankimore se Akt Emërimi është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht ankuesi pretendon që të anulohet Akt Emërimit me numër AE. Nr. 141/2022 të datës 30.08.2022 si dhe kërkon vazhdimin e funksionimit të Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 22.07.2013 e lidhur me mes të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë dhe ankuesit [redacted] në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Cilësi", sipas Ligjit dhe akteve tjera nënligjore të AKF-së dhe Ligjit të Punës.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë përmes Udhëheqësit të Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, më datë 07.10.2022 dhe 13.10.2022 përmes shkresës zyrtare ka dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimin me Nr. protokoli AKF/2022-157 të datës 06.10.2022 mbi Deklarimin e Statusit të Nëpunësit për ankuesin [redacted] si dhe përmes kësaj shkrese Agjencia e ka njoftuar Këshillin se me datë 06.10.2022 Zëvendësuesja e Zyrtarit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë ka nxjerrë Vendim me numër protokoli AKF/2022-158, me të cilin vendim është



Anuluar Akt Emërimi me numër AE. Nr. 141/2022 ti datës 30.08.2022 për ankuesin [redacted] [redacted] lëshuar nga Zëvendësuesja e Zyrtarit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli AKF/2022-158, me të cilin vendim është Anuluar Akt Emërimi me numër AE. Nr. 141/2022 i datës 30.08.2022 për ankuesin [redacted] i lëshuar nga Zëvendësuesja e Zyrtarit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, i cili ka qenë edhe pretendim i ankuesit, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast pretendimi i ankuesit është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjësisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 i cili thekson se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”,* andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 29.09.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.833/2022

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

